



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.310/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.06.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Rada Oil Industry” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-89536-03-10-2021, me objekt “*Menaxhimi i Mbetjeve*”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 67,781,914 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 06.04.2021 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” SH.A.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” ShPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:** “Alko Impex General Construction” SHPK  
Rruga “Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga, Tiranë

“Rada Oil Industry” SHPK  
Xhafzotaj, godinë 1-katëshe ngjitur me tregun rural të fruta perimeve, Durrës

**Autoriteti Kontraktor:** “Albanian Gas Services Company” SH.A  
Rruga e Kosovarëve, Pallati Ndërpro ShPK, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.03.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-89536-03-10-2021, me objekt “*Menaxhimi i Mbetjeve*”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 67,781,914 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.04.2021 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” SH.A.

II.2. Në datën 06.04.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 29.04.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

Pastrime Silvio	pa ofertë	I skualifikuar
Rada Oil Industry	44,597,430	I kualifikuar
Alko –Impex General Construction	59,596,800	I kualifikuar

II.4. Në datën 05.05.2021 operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” ShPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë

- *Duke vlerësuar se kualifikimi i OE Rada Oil Industry është kryer në kundërshtim me ligjin paraqesim këtë ankesë për sa më poshtë:  
Nga një kërkim i thjeshtë në faqen zyrtare të QKB vërejmë se kjo shoqëri disponon 3 zyra të ushtrimit të aktivitetit e konkretisht:*
  - *Selia e shoqërisë me adresë Xhafzotaj Shijak pranë tregut rural.*
  - *Vlorë lagjja uji i ftohtë pallati i ri Alb Millenium kati 2*
  - *Durrës Rrushbull Shkallnur në portin e Durrësit.*
- Sa më sipër çmojmë se KSHA duhet të marrë në shqyrtim dhe të analizojë nëse në vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri janë të përfshira të gjitha kontratat në të cilat kjo shoqëri ushtron aktivitet*

- *Së dyti nga AK në DT është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për ekzekutimin me sukses të kontratës sipas tabelës me poshtë. Mjetet 1,2,3,4,5,6,7,8..*  
*Duke ju referuar sërish ekstraktit të kësaj shoqërie në faqen zyrtare të QKB vërejmë se kjo shoqëri nuk disponon asnjë mjet të deklaruar në pronësi të saj çka do të thotë se në plotësim të kushteve të mësipërme kjo shoqëri ka deklaruar si mjete për realizimin me sukses të kontratës ato të marra me qira.*  
*Së pari referuar DT disponimi nëpërmjet qirasë nuk është një formë ligjore në plotësim të kriterit pasi autoriteti kontraktor e ka kufizuar provueshmërinë e disponimit të tyre vetëm në dy forma: 1. Nëpërmjet pronësisë së mjetit; 2. Nëpërmjet kontratës leasing.*  
*Mjetet e deklaruara nga shoqëria Rada Oil Industry ShPK me qira nuk duhet të merren në konsideratë pasi mendojmë se janë mjete që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DT pasi konkretisht këto mjete nuk janë të pajisura me certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit në kushtet kur këto mjete janë marrë me qira pasi këto mjete kanë vetëm certifikatë për transport mallrash për llogari të vet.*  
*Ligji për transportet rrugore bën qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për transport për vete përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion në ardhje ose në kthim vetëm për llogari të veprimtarisë së vet ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si dhe certifikatës së lëshuar për transport për të tretë dhe me qira përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. Në këtë mënyre kryerja e transportit nga ana e shoqërisë Rada Oil Industry të mallrave me kamionët e shoqërive qiradhënëse do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit për transportet rrugore është i ndaluar. Mungesa e këtij dokumenti vërteton vetëm faktin se mjete mund të jetë në pronësi por përdorimi i tij do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor dhe ligjit për transportet rrugore. Mungesa e këtij dokumenti do të sillte pamundësinë e realizimit me sukses të kontratës pasi mjetet nuk do kishin mundësi të qarkullonin.*
- *Së treti në DT është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO si më poshtë:*
  - i. *Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.*
  - ii. *Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit . Të gjitha certifikatat e mësipërme të jenë lëshuar nga një organ i akredituar. Kur operatori ekonomik hyn si bashkim operatorësh ekonomikë, secili operator pjesëmarrës duhet t'i plotësojë ISO sipas zërave që ka marrë përsipër të realizojë në marrëveshjen e bashkëpunimit.*

*OE ankimues ka një eksperiencë të konsiderueshme në fushën e menaxhimit të mbetjeve jo vetëm sa i përket kapaciteteve teknike dhe profesionale por edhe eksperiencën ndër vite dhe një ndër kompanitë lider në këtë fushë. Nga një verifikim online çmohet se në kushtet kur ky operator është kualifikuar prezumohet se ka paraqitur dhe certifikatat ISO për të cilat kemi bindjen që janë lëshuar nga organe të paakredituar pasi vlerësojmë se një shoqëri me kapacitete minimale si ajo e OE të kualifikuar në vend të parë e ka të pamundur për ti marrë nga organe të akredituara në RSH duke marrë në konsideratë kriteret dhe dokumentacionin që kërkohet për tu licencuar me certifikatat e mësipërme.*

*Sa më sipër kërkojmë skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria Rada Oil Industry.*

II.5. Në datën 12.05.2021 me shkresën nr.8/12 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijëni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 12.05.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 06.05.2021 operatori ekonomik “Rada Oil Industry” ShPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Më datë 29.04.2021 jemi informuar për kompanitë e kualifikuara. Një nga kompanitë e kualifikuara është edhe shoqëria Alko Impex General Construction.*
- *Sipas verifikimeve në QKL rezultoi se kompania e sipërpërmendur nuk është e pajisur me licencat e duhura për realizimin e kësaj kontrate . Licencat që ajo posedon nuk janë në përputhje me objektin e prokurimit Menaxhim i mbetjeve.*
- *Gjithashtu nga verifikimet në QKB rezulton se automjetet nuk janë në përputhje me këtë lloj aktiviteti.*
- *Për sa më sipër kërkojmë rivlerësimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria Alko Impex General Construction ShPK.*

II.8. Në datën 12.05.2021 me shkresën nr.8/12 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijëni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.9. Në datën 20.05.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr.8/15 prot datë 24.05.2021 protokolluar me tonën me nr.793/2 prot datë 26.05.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ‘Alko Impex General Construction’ ShPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik Rada Oil ShPK me arsyetimin se “Nga një kërkim i thjeshtë në faqen zyrtare të QKB vërejmë se kjo shoqëri disponon 3 zyra të ushtrimit të aktivitetit e konkretisht: Selia e shoqërisë me adresë Xhafzotaj Shijak pranë tregut rural. Vlorë lagjja uji i ftohtë pallati i ri Alb Millenium kati 2 Durrës Rrushbull Shkallnur në portin e Durrësit. Sa më sipër çmujmë se KSHA duhet të marrë në shqyrtim dhe të analizojë nëse në vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, janë të përfshira të gjitha kontratat në të cilat kjo shoqëri ushtron aktivitet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

*Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:*

*a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;*

*b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*

*c. Sigurimi i ofertes (nuk kerkohet);*

*d. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

*e. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*

*f. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1;*

*g. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Rada Oil Industry ShPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kthim përgjigje Nr.928/1 prot datë 24.03.2021 e Furnizuesit të Shërbimit Universal OSHEE Group drejtuar Z.P.GJ me përmbajtje si vijon: *Në vijim të kërkesës suaj me Nr.928 prot datë 24.03.2021 të depozituar pranë shoqërisë FSHU SH.A lidhur me kërkesën që ju parashtroni ju bëjmë me dije se: Nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kompaninë Rada Oil Industry nuk rezulton të ketë kontratë me FSHU SH.A.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa neni 53, pika 3 përcakton: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”*

III.1.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma “c”, përcaktohet se: *“Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rasti kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.*

III.1.5. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr.109, datë 21.10.2011 të ERE “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”*

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “Rada Oil Industry” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike Kthim përgjigje Nr.928/1 prot datë 24.03.2021 e Furnizuesit të Shërbimit Universal OSHEE Group drejtuar Z.P.GJ me përmbajtje si vijon: *Në vijim të kërkesës suaj me Nr.928 prot datë 24.03.2021 të depozituar pranë shoqërisë FSHU SH.A lidhur me kërkesën që ju parashtroni ju bëjmë me dije se: Nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kompaninë Rada Oil Industry nuk rezulton të ketë kontratë me FSHU Sh.A.*

III.1.7. Referuar sa më sipër, Komisioni vëren se vërtetimi i mësipërm është lëshuar në kushtet e vetëdeklarimit të operatorit ekonomik ankimues pasi operatori ekonomik ankimues nuk rezulton të këtë në cilësinë e titullarit apo përdoruesit asnjë kontratë të regjistruar në sistemin e FSHU SH.A. Duke u kthyer te arsyeja e skualifikimit, përpara se të konkludohet në një qëndrim përfundimtar mbi përmbushjen apo jo të kriterit të kualifikimit nga operatori ekonomik “Rada Oil Industry” SHPK, Komisioni gjykon të ndalet dhe të analizojë ndarjen ndërmjet detyrimeve të një operatori ekonomik për përmbushjen e një kriteri kualifikimi të kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe mënyrës së përmbushjes së këtij kriteri nga operatori ekonomik. Në lidhje me detyrimin për përmbushjen e një kriteri kualifikimi, neni 46, pika 1 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” e përcakton qartë se operatorët ekonomik kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme dhe nëse nuk plotësohet qoftë një kriter i vetëm, autoriteti kontraktor është i detyruar që të refuzojë ofertën. Ndërsa në lidhje me mënyrat e përmbushjes së kriterëve për kualifikim, Komisioni thekson se përcaktohen ose nga vetë autoriteti kontraktor, i cili vendos dokumentacionin që duhet paraqitur në SPE në dokumentet e tenderit, gjithmonë brenda diskrecionit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi ose janë të parashikuara në mënyrë të shprehur në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkretë, pretendimi lidhet me më përmbushjen e një kriteri i cili është i sanksionuar në nenin 27, pika 5, gërma “c”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet edhe dokumenti konkretë me anë të të cilit përmbushet ky kriter. Në këtë dispozitë, përcaktohet se të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet që me anë të një vërtetimi të konfirmojnë shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri dhe mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Gjithashtu, në po këtë dispozitë është përcaktuar se subjekti që lëshon këtë vërtetim është furnizuesi me energji elektrike.

III.1.8. Referuar nenit 27, pika 5, gërma “c”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ndarja ndërmjet plotësimit apo mosplotësimit të këtij kriteri është paraqitja ose jo e vërtetimit të lëshuar nga Furnizuesi me energji elektrike, si dhe shlyerja ose jo e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për kontratat që operatori ekonomik është titullar apo përdorues. Në rastin konkretë, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur një vërtetim nga FSHU që konfirmon se nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kompaninë Rada Oil Industry nuk rezulton të ketë kontratë me FSHU Sh.A. Në këto kushte, për sa kohë që vetë subjekti që verifikon dhe ka tagrin që të vërtetojë ekzistencën e detyrimeve dhe debive që palët kanë ndaj tij, nuk e konsideron si debitor operatorin ekonomik ankimues, si dhe për sa kohë është paraqitur një vërtetim që konfirmon se subjekti nuk ka një kontratë të lidhur me FSHU atëherë Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Rada Oil Industry” SHPK e ka përmbushur kriterin e vecantë të kualifikimit. Akoma më tej, Komisioni gjykon se fakti që një operator ekonomik deklaroi disa adresa alternative të ushtrimit të aktivitetit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, nuk mund



të paragjykohet se domosdoshmërisht është titullar, përdorues apo konsumator i energjisë elektrike dhe për më tepër debitor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” ShPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik Rada Oil Industry ShPK me arsyetimin se “Së dyti nga AK në DT është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për ekzekutimin me sukses të kontratës sipas tabelës me poshtë. Mjetet 1,2,3,4,5,6,7,8.. Duke ju referuar sërish ekstraktit të kësaj shoqërie në faqen zyrtare të QKB vërejmë se kjo shoqëri nuk disponon asnjë mjet të deklaruar në pronësi të saj çka do të thotë se në plotësim të kushteve të mësipërme kjo shoqëri ka deklaruar si mjete për realizimin me sukses të kontratës ato të marra me qira. Së pari referuar DT disponimi nëpërmjet qirasë nuk është një formë ligjore në plotësim të kriterit pasi autoriteti kontraktor e ka kufizuar provueshmërinë e disponimit të tyre vetëm në dy forma: 1. Nëpërmjet pronësisë së mjetit; 2. Nëpërmjet kontratës leasing. Mjetet e deklaruara nga shoqëria Rada Oil Industry ShPK me qira nuk duhet të merren në konsideratë pasi mendojmë se janë mjete që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DT pasi konkretisht këto mjete nuk janë të pajisura me certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit në kushtet kur këto mjete janë marrë me qira pasi këto mjete kanë vetëm certifikatë për transport mallrash për llogari të vet. Ligji për transportet rrugore bën qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për transport për vete përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion në ardhje ose në kthim vetëm për llogari të veprimtarisë së vet ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si dhe certifikatës së lëshuar për transport për të tretë dhe me qira përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. Në këtë mënyrë kryerja e transportit nga ana e shoqërisë Rada Oil Industry të mallrave me kamionët e shoqërive qiradhënëse do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit për transportet rrugore është i ndaluar. Mungesa e këtij dokumenti vërteton vetëm faktin se mjeti mund të jetë në pronësi por përdorimi i tij do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor dhe ligjit për transportet rrugore. Mungesa e këtij dokumenti do të sillte pamundësinë e realizimit me sukses të kontratës pasi mjetet nuk do kishin mundësi të qarkullonin.

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteret si më poshtë:

- a) Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për ekzekutimin me sukses të kontratës sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Mjetet	Numri min. i mjeteve	Kapaciteti minimal	Dokumentet që duhet të paraqesë operatori ekonomik për secilën nga mjetet dhe pajisjet
1	Mjete teknologjike (Kamion) për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve urbane	2	Min 18 T	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Leja e qarkullimit ose kontrata e leasing</li> <li>• Leja e drejtimit e të paktën një shoferi të autorizuar</li> </ul>
2	Autobot për transportin e mbetjeve vajore i pajisur me bllokues të shkëndijave	1	Min 5000 lt	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Leja e qarkullimit ose kontrata e leasing</li> <li>• Leja e drejtimit e të paktën një shoferi të autorizuar</li> <li>• Vetë deklarata e pajisjes me bllokuesin të shkëndijave për mjetin (spark arrestor).</li> </ul>
3	Autobot për transportin e ujrave të zeza i pajisur me bllokues të shkëndijave	1	Min 2500 lt	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Leja e qarkullimit ose kontrata e leasing</li> <li>• Leja e drejtimit e të paktën një shoferi të autorizuar</li> <li>• Vetë deklarata e pajisjes me bllokuesin e shkëndijave për mjetin (spark arrestor)</li> </ul>
4	Kamionë ose kamioncina transporti me kontenier për transportin e mbetjeve të riciklueshme	1	Min 10 m <sup>3</sup>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Leja e qarkullimit ose kontrata e leasing</li> <li>• Leja e drejtimit e të paktën një shoferi të autorizuar</li> <li>• Vetë deklarata e pajisjes me bllokuesin e shkëndijave për mjetin (spark arrestor)</li> </ul>

5	<i>Kamionë ose kamioncina transporti me kontenier për transportin e mbetjeve të rrezikshme</i>	1	Min 300 KË (kuaj fuqi)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Leja e qarkullimit ose kontrata e leasing</li> <li>• Leja e drejtimit e të paktën një shoferi të autorizuar</li> <li>• Vetë deklarata e pajisjes me bllokuesin e shkëndijave per mjetin (spark arrestor)</li> </ul>
6	<i>Kontenier</i>	5	Min 3 m <sup>3</sup>	<i>Fatura e blerjes ose kontrata e qerasë</i>
7	<i>Kosha</i>	30	Min 1 m <sup>3</sup>	<i>Fatura e blerjes ose kontrata e qerasë</i>
8	<i>Rakorderi presioni me lidhje të shpejtë 2''</i>	1	Sipas ISO 14420-7	<i>Fatura e blerjes ose kontrata e qerasë</i>  <i>Vetë deklarata e përputhshmërisë me ISO-n</i>

*Për plotësimin e këtij kriteri duhet që:*

- i. *Operatori ekonomik të paraqesë dokumentet provuese të disponimit të mjeteve dhe pajisjeve teknike në dispozicion të përcaktuara në tabelën e mësipërme, përkatesisht “Dokumentet që duhet te paraqesë operatori ekonomik per secilen nga mjetet dhe pajisjet”.*

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”.

III.2.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk rezulton të jetë kërkuar disponimi i mjeteve vetëm në formën e pronësisë ose me leasing. Pra autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka përjashtuar në kriterin e vecantë të kualifikimit formën e disponimit të mjetetit me anë të kontratës së qirasë. Në tabelën e sipërcituar përcaktohet dokumentacioni që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të provuar disponimin e mjeteve e konkretisht kërkohet të paraqitet Leja e qarkullimit ose kontrata e leasing. Leja e qarkullimit vlen njësoj për mjetet në pronësi dhe mjetet me qira. Fakti që autoriteti kontraktor nuk e ka shprehur se për disponimin e mjeteve duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë nuk do të thotë se ai ka përjashtuar këtë formë disponimi e cila është e mbështetur në dispozitat e Kodit Civil si një nga mënyrat ligjore të disponimit të sendeve. Gjithashtu edhe dokumenti certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit për të cilën ankimesi ngre pretendime nuk rezulton të jetë kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit të dokumentive të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. KPP sqaron se kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm

nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter apo specifikim tjetër i cili nuk është i përfshirë në dokumentet e tenderit kjo në kuptim të nenit 55 “Kriteret e Përcaktimit të Ofertës Fituese” pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” ShPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik Rada Oil Industry ShPK, me arsyetimin se , *Së treti në DT është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO si më poshtë: Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit. Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit . Të gjitha certifikatat e mësipërme të jenë lëshuar nga një organ i akredituar. Kur operatori ekonomik hyn si bashkim operatorësh ekonomikë, secili operator pjesëmarrës duhet t’i plotësojë ISO sipas zërave që ka marrë përsipër të realizojë në marrëveshjen e bashkëpunimit. OE ankimues ka një eksperiencë të konsiderueshme në fushën e menaxhimit të mbetjeve jo vetëm sa i përket kapaciteteve teknike dhe profesionale por edhe eksperiencën ndër vite dhe një ndër kompanitë lider në këtë fushë. Nga një verifikim online çmojmë se në kushtet kur ky operator është kualifikuar prezumohet se ka paraqitur dhe certifikatat ISO për të cilat kemi bindjen që janë lëshuar nga organe të paakredituar pasi vlerësojmë se një shoqëri me kapacitete minimale si ajo e OE të kualifikuar në vend të parë e ka të pamundur për ti marrë nga organe të akredituara në RSH duke marrë në konsideratë kriteret dhe dokumentacionin që kërkohet për tu licencuar me certifikatat e mësipërme. Komisioni i Prokurimit Publik vëren,*

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3/b “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

b) *Operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO si më poshtë:*

- iii. *Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.*
- iv. *Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit .*

*Të gjitha certifikatat e mësipërme të jenë lëshuar nga një organ i akredituar. Kur operatori ekonomik hyn si bashkim operatorësh ekonomikë, secili operator pjesëmarrës duhet t’i plotësojë ISO sipas zërave që ka marrë përsipër të realizojë në marrëveshjen e bashkëpunimit.*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Rada Oil Industry” ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Certifikatë ISO 14001:2015 lëshuar nga CertiW për objektin e aktivitetit Mbledhja dhe transporti i mbeturinave ofrimi i shërbimeve të pastrimit civil.
- Certifikatë ISO 9001:2015 lëshuar nga CertiW për objektin e aktivitetit Mbledhja dhe transporti i mbeturinave ofrimi i shërbimeve të pastrimit civil.

III.3.3 Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit... .”*

III.3.4. Në nenin 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: *“Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”.*  
*Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.*

III.3.5. Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar rekomandimi mbi hartimin e kërkesave të cilësisë i nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, datë 20.03.2018 (data e protokollimit pranë APP), shoqëruar me Manualin teknik *“Mbi mënyrën e marrjes së informacionit për organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit/organizma akreditues të huaj, të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen e reciprocitetit me Republikën e Shqipërisë”.*

Në këtë rekomandim, është përcaktuar: *“Të gjitha certifikatat e cilësisë, të cilat vlerësohen të nevojshme të kërkohen nga autoriteti kontraktor, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë”.*

Gjithashtu, në manualin teknik, përcaktohen mënyrat, se si merret informacioni për organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit/organizma

akreditues të huaj, të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen e reciprocitetit me Republikën e Shqipërisë. Në këtë manual janë të përcaktuara detajet në lidhje me organet e vlerësimit të konformitetit (OVK), organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, mënyrën se si mund të merret informacioni nëse një OVK është i akredituar apo jo nga DPA, mënyrën se si mund të merret informacion nëse certifikata apo raporti i lëshuar nga OVK e akredituar është aktualisht i vlefshëm, si mund të merret informacion nëse një OVK është akredituar nga organizma akreditues të huaj, mënyrën si mund të gjendet që një OVK është e akredituar nga një organizëm akreditues dhe cila është fusha e akreditimit.

III.3.6. Sikundër pasqyruar më sipër shoqëria “Rada Oil Industry” ShPK është pajisur me certifikatat ISO 14001:2015 dhe ISO 9001:2015 lëshuar nga CertiW për objektin e aktivitetit Mbledhja dhe transporti i mbeturinave ofrimi i shërbimeve të pastrimit civil. Nga verifikimi, i manualit teknik, sipas të cilit DPA njih të barazvlefshëm certifikata akreditimi të lëshuara nga organet akredituese që kanë nënshkruar marrëveshje të njohjes reciproke, KPP konstaton se subjekti “Certi W” është i akredituar nga organi akreditues Latak për të lëshuar certifikatat e sipërcituara. Ky fakt provohet nga KPP pas verifikimeve në faqen zyrtare të Latak ku konstatohet se kompania Certi W është akredituar për të lëshuar certifikatat ISO 14001: 2015 dhe 9001:2015. Në këtë kuptim KPP gjykon se në rastin konkret provohet se kompania Certi W është i akredituar nga Latak për standardin e kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi EN ISO 9001 dhe 14001e rrjedhimisht është në kushtet e plotësimit të kriterit të veçantë të kualifikimit lidhur me dorëzimin e certifikatave ISO të sipërcituara.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Rada Oil Industry sh.p.k mbi kualifikimin e operatorit ekonomik Alko Impex General Construction ShPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues Rada Oil Industry ShPK ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik Rada Oil Industry SHPK nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” ShPK për procedurën e prokurimit, *Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-89536-03-10-2021, me objekt “*Menaxhimi i Mbetjeve*”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 67,781,914 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 06.04.2021 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” SH.A.
  2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rada Oil Industry” ShPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
  3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 793 Protokolli; Datë 12.05.2021**

**Nr.863 Protokolli; Datë 20.05.2021**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**